

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Kakavijë/ 685 kg mish viçi dhe 83 kg peshk kontrabandë në autobusët nga Athina, arrestohet shoferi
ADRESA	https://www.gazetatema.net/kronika/kakavije-685-kg-mish-vici-dhe-83-kg-peshk-kontrabande-ne-autobuset-nga-a-i585064
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	9 shtator 2026, 20:07:14 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	9 shtator 2026, 20:50:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	d188e0d51566c79de599abfe110e33bff035e6fcf951b168676b3076158e5145
TEKSTI	e757dea5511e0ded5122d4df21169f9948f2d428f91e9318d9caedfc253a1f3e
PAMJA	11ac8aa602007fb8b1e778890b537236f7cd0d57384daa50f1bb54b63f067a20

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	3b76372ee59ae69b9794e015b2387fed5f6d6933b806ab4ec3b7ba5f72f0fcee
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/3b76372ee59ae69b9794e015b2387fed5f6d6933b806ab4ec3b7ba5f72f0fcee>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px

- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by
[Kontakt](#)

English

1 e [VIDE-O/ "Edhe bar do hamë dhe gjak do derdhim" - aktivisti rikthen retoriken e Ramiz Alisë, teksa mbron lincimin e deputeteve Pogradec/ La makinën me çelës brenda, 48-vjeçarar përtiton nga rrugës](#)

Kakavijë/ 685 kg mish viçi dhe 83 kg peshk kontrabandë në autobusët nga Athina, arrestohet shoferi

9 Shtator 2026, 22:50Kronika TEMA



 Kakavijë/ 685 kg mish viçi dhe 83 kg peshk kontrabandë në

Policia Kufitare e Kakavijës ka sekuestruar sasi mishi e peshku kontrabandë, të cilat ishin futur në Shqipëri përmes linjave ndërkombëtare të autobusëve që vinin nga Athina.

Në autobusin e linjës Athinë-Gjirokastrë që drejtohej nga një 54-vjeçar tashmë i arrestuar, u gjetën 685 kilogramë mish viçi, të prerë në formë bërçollash.

Rasti tjetër ishte në autobusin e linjës Athinë-Shkodër ku në 4 kuti kartoni ishin futur 82 kilogramë e 900 gramë peshk. Shoferi, një 46-vjeçar, është vënë nën hetim.

Njoftimi i plotë:

Gjatë kontrolleve të ushtruara në dy autobusë të linjave ndërkombëtare, uniformat blu zbuluan sasi të konsiderueshme mishi dhe peshku, të cilat dyshohet se ishin futur kontrabandë në territorin shqiptar.

Në rastin e parë, gjatë kontrollit të autobusit të linjës Athinë-Gjirokastrë, me drejtues shtetasin A.B., 54 vjeç, banues në Gjirokastrë, u gjetën dhe u sekuestruan 685 kilogramë mish viçi, të prerë në formë bërçollash.

Për këtë rast, drejtuesi i autobusit u arrestua në flagrancë dhe ndaj tij u referuan veprimet për veprën penale “Kontrabanda me mallra të tjerë”, parashikuar nga neni 174 i Kodit Penal.

Ndërkohë, rasti i dytë u evidentua gjatë kontrollit të autobusit të linjës Athinë-Shkodër, me drejtues shtetasin D.M., 46 vjeç, banues në Elbasan.

Në këtë autobus u gjetën katër kuti kartoni, brenda të cilave kishte një sasi prej 82 kilogramësh e 900 gramësh peshk, e cila dyshohet se ishte futur kontrabandë në territorin shqiptar.

Në lidhje me këtë rast, u kryen veprimet hetimore në ngarkim të shtetasit D.M., për veprën penale “Kontrabanda me mallra të tjerë”. Ai do të ndiqet në gjendje të lirë.

Sasitë e mishit dhe peshkut u sekuestruan në cilësinë e provës materiale, ndërsa materialet procedurale i janë referuar organeve kompetente për vijimin e hetimeve.

Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

[Pogradec/ La makinën me çelësa brenda, 48-vjeçari përfiton nga rasti dhe e vjedh! Arrestohet pas ndjekjes](#)

21:50 Kronika

[Sarandë/ I arrestuari dëmtoi kamerën, tavanin dhe orenditë në komisariat, pezullohen 3 efektivë që nuk reagues](#)

21:40 Kronika / 1 koment

[Të ardhurat nga qiradhënia e pasurive të sekuestruara dhe konfiskuara rriten me 30%, afro 2 milionë euro në 8 muaj](#)

20:30 Kronika / 1 koment

[Zjarr në Finiq/ Digjet një sipërfaqe me pemë dhe shkurre, rrezikohen edhe banesat](#)

19:40 Kronika

[37 mijë ha tokë e djegur nga zjarret këtë verë, dy herë më pak se vjet](#)

19:00 Kronika

[“Sakrifica jote nuk do të harrohet”, kryepolici Hita viziton efektivin e plagosur në Maliq: Do jem në krah të çdo punonjësi](#)

18:30 Kronika

[APSK: Të ardhurat nga qiradhënia e pasurive të sekuestruara dhe konfiskuara u rritën me 30%, afro 2 milionë euro në 8-mujor](#)

17:40 Kronika

[Kreu i AMP pret të dërguarin e Trump, Zampolli! Në fokus lufta ndaj fentanilit dhe kundër trafikut të drogës](#)

15:23 Kronika

[Emri/ Ekzekutimi i shqiptarit në Itali, ja kush është 35-vjeçari që u gjet në bagazhin e një makine me duar të lidhura!](#)

14:50 Kronika / 13 komente

[Burgjet nën “përgjim”, 148 punonjës dhe 196 të izoluar të proceduar, kontrolle edhe ndaj familjarëve!](#)

12:15 Kronika / 1 koment

Më të lexuarat

24 orët e fundit

Javën e fundit

[Do blinte toka në Shqipëri, do investonte në Bogovë dhe u...](#)

22:50 Kronika / 7 komente

“A nuk ju vjen turp?” - Rama u përgjigjet Demokratëve Eur...

11:53 Politika / 98 komente

Protestuesit ndoqën deputeten Iris Luarasi me thirrje fye...

21:50 Politika / 92 komente

Republika popullore e protestës

15:20 Editorial / 76 komente

U pretendua se aktivistja u arrestua pas denoncimit të sa...

15:13 Politika / 63 komente

Blog Tema

Koinçidenca misterioze e 12 shtatorit, ‘Flamingot’ përplasen me ‘UÇK’

19:20 Blog / 14 komente

Sa të interesuar janë adoleshentët shqiptarë për politikën?

17:30 Blog

Pandeli Majko: Liria nuk gjykohet...

13:00 Blog / 18 komente

Lajme ekskluzive!

Nëse doni të jeni i pari për t'u informuar mbi lajme ekskluzive, regjistrohuni më poshtë.

Ju mund të çregjistroheni në çdo moment.

 Powered by Tomorrow.io

TemaA është një gazetë e përditshme e palidhur politikisht e botuar në Tiranë, Shqipëri në gjuhën shqipe. E themeluar në korrik 1999, TemaA është një nga gazetat ditore më të vjetra në Shqipëri dhe aktualisht shet rreth 15,000 kopje ditore në mbarë vendin.

- 
- 
- 
- 
- 

Built and Monetized by

- [Politika](#)
 - [Kronika](#)
 - [Editorial](#)
 - [Blog](#)
 - [Bota](#)
 - [Sport](#)
 - [Shëndeti](#)
 - [Turizëm](#)
 - [Kontakt](#)
 - [Te dhënat personale](#)
 - [Cookies](#)
- [Sociale](#)
 - [Ekonomia](#)
 - [Antena](#)
 - [Rajoni](#)
 - [Kulturë](#)
 - [Lifestyle](#)
 - [Dossier](#)
 - [Hi-Tech](#)

Built and Monetized by